

---

**MISIONI VËZHgues NDËRKOMBËTAR I ZGJEDHJEVE**  
**ish Republika Jugosllave e Maqedonisë**  
**Zgjedhje Parlamentare – 5 korrik 2006**

---

**DEKLARATË MBI REZULTATET DHE KONKLUDIMET PRELIMINARE**  
**(VERZIONI I PËRMIRËSUAR)**

**Shkup, 6 korrik 2006** – Me ftesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme për vëzhgimin e zgjedhjeve të 5 korrikut në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejta të njeriut (OSBE/ODIHR) më 30 maj vendosi Misionin vëzhgues të zgjedhjeve (MVZ). Me qëllim vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve dhe me qëllim formimin e një Misioni ndërkombëtar për vëzhgimin e zgjedhjeve OSBE/ODIHR u shoqërua nga një delegacion i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE).

Ky raport i të dhënave dhe konkludimeve preliminare komunikohet para përfundimit të procesit zgjedhor, duke përfshirë tabelizimin dhe shpalljen e rezultateve finale, si dhe para skadimit të afateve ligjore për të marrë parasysh ankesat eventuale. Vlerësimi definitiv i tërë procesit zgjedhor do të varet pjesërisht nga rrjedha e fazave tjera të procesit. OSBE/ODIHR do të shpall Raportin final, përafërsisht dy muaj pas kompletimit të procesit dhe ky Raport do të përfshijë analizë gjithëpërfshirëse të të dhënave të mbledhura nga vëzhguesit dhe do të ofrojë rekomandime për përmirësim të mëtutjeshëm të procesit zgjedhor. Delegacioni i PACE do të prezantojë konkludimet e veta në sesioni plenar të Asamblesë në tetor të vitit 2006.

---

**KONKLUDIMET PRELIMINARE**

---

Zgjedhjet Parlamentare të 5 korrikut në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë i japin rast OSBE/ODIHR-së që për herë të nëntë të ushtrojë vëzhgim rrënjësor të zgjedhjeve në vend. Derisa zgjedhjet u mbajtën në pajtueshmëri të madhe me përkushtimet e OSBE dhe të Këshillit të Evropës për zgjedhje demokratike, rastet e dhunës dhe kërcënimeve gjatë fazës së parë të fushatës zgjedhore si dhe rastet e izoluar të parregullsisve<sup>1</sup> serioze gjatë ditës së zgjedhjeve hodhën hije mbi procesin i cili në përgjithësi ishte i administruar mirë dhe u mbajt në atmosferë garuese.

Përderisa dita e zgjedhjeve kaloi në atmosferë të qetë dhe u realizua në mënyrë të rregullt në pjesën më të madhe të vendit dhe paraqitja e Bordeve Zgjedhore (BZ) u vlerësua pozitivisht në pjesën më të madhe të vendotimeve. Megjithatë, parregullsi serioze, që dëmtuan univerzalitetin dhe barabarësinë e votës u raportuan në një sërë komunash, në veçanti nga Bogovinja, Bërvenica, Gostivari, Struga, Studeniçani, Tearca, Zajazi, dhe Zhelina. Në to përfshihen raste të izoluar të mbushjes së kutive, blerjes së votave dhe raste të tensionit dhe kërcënimeve. Rastet e votimeve në grupe dhe votimi për dikë tjetër ishin më të shpeshta. Procedura e votimit nuk është respektuar në tërësi dhe parandalimet për votim të shumëfishtë nuk janë implementuar. Megjithatë, situata humbi orientimin gjatë numërimit të votave, gjë e cila u vlerësua si negative në 15 përlind të vendotimeve të vëzhguara, ose një në shtatë raste. Përderisa nuk kishte orvatje të qëllimshme për të manipuluar me rezultatet e

---

<sup>1</sup> Në versionin paraprak të deklaratës, pjesa ‘rastet e izoluar të parregullsisve’ u bë lëshim si rezultat i gabimit teknik.

protokollit, parregullsi serioze janë vërejtur në 7 përqind të vendvotimeve të vëzhguara, ndërsa problemeve të mëdha procedurale në 12 përqind të vendvotimeve.

Vetitë e mëposhtme pozitive karakterizuan procesin zgjedhor, disa prej të cilave disa u implementuan si rezultat i rekomandimeve të mëparshme:

- Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KShZ), me një proces gjithëpërfshirës aprovoi të gjitha listat e prezantuara nga 31 parti politike dhe koalicione dhe dy grupe votuesish.
- Elektoratit iu mundësua një atmosferë garuese dhe zgjedhje të gjerë të alternativave politike, përfshirë këtu edhe zgjedhjen brenda komuniteteve etnike.
- Në përgjithësi, mediumet elektronike dhe shtypi u siguroi votuesve një shumëllojshmëri të këndvështrimeve politike duke u lejuar të bëjnë zgjedhjen e tyre në bazë të informatave.
- Përsikaj faktit që Kodi i ri Zgjedhor u përfundua vetëm tre muaj para zgjedhjeve, legjislativë e konsoliduar siguroi një bazë më të qëndrueshme për zgjedhjet.
- Përmbajtja e re e Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KShZ) dhe 84 Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) kryen përgatitjet zgjedhore në një mënyrë tejet efektive, kolegjinale dhe konsensuale, duke respektuar të gjitha afatet ligjore.
- Për herë të parë, KShZ u përkrah nga një sekretariat i përhershëm.
- Kodi Zgjedhor vendosi kuota gjinore për listat e kandidatëve dhe organet administrative zgjedhore, si dhe dispozita që synojnë të garantojnë përfaqësim adekuat të pakicave kombëtare në administratën zgjedhore.
- Paraqitja e BZ-ve u vlerësua si adekuate, e mirë ose shumë e mirë në 97 përqind të vendvotimeve.
- Vëzhguesit e MNVZ raportuan se gjatë ditës së zgjedhjeve policia ka luajtur rol pozitiv në mirëmbajtjen e rendit sipas nevojës.
- Numri më i madh i vëzhguesve vendor jo-partiakë, sidomos nga organizata MOST kontribuan që dita e zgjedhjeve të jetë transparente.

Njëkohësisht janë vënë re edhe mangësitë e mëposhtme:

- Gjysma e parë e fushatës zgjedhore u njollos nga një sërë incidentesh të dhunshme, duke përfshirë edhe sulme mbi shtabet zgjedhore, zënka mes aktivistëve partiak dhe incidente të armatosura, por pa viktima. Incidentet e tilla ndodhën në komunat e Sarajit, Tearcës, Likovës, Studeniçanit, Strugës, Tetovës dhe në komunën Qendër të Shkupit.
- Gjithashtu vëzhguesit e MVZ kanë vërejtur raste të keqpërdorimit të burimeve administrative, posaçërisht nga ana e zyrave të prefektëve.
- Televizioni shtetëror, Televizioni i Maqedonisë në emitimin e vet favorizoi partitë qeveritare.
- Komisioni Shtetëror për Antikorrupcion identifikoi dy raste të shitjes joligjore të pronës shtetërore gjatë fushatës zgjedhore dhe ftoi institucionet relevante për hetim të mëtejshëm të rastit.
- Partitë politike bënë akuza të gjëra për presion mbi votuesit, duke përfshirë edhe raste të blerjes së votave të cilat u konfirmuan nga MVZ.
- Aspekte të veçanta të Kodit Zgjedhor u treguan të vështira për tu implementuar, siç ishte rasti me rregullën që të gjithë kryetarët e Bordeve Zgjedhore të jenë autoritete shtetërore ose komunale.
- Trajnimi i KKZ-ve dhe BZ-ve u krye me vonesë dhe në mënyrë jo të duhur. Në shumë raste, zyrtarët zgjedhorë pranuan manualin për BZ një ditë para ditës së zgjedhjeve.
- Pothuajse gjysma e gjykatave të shkallës së parë që i kontaktuam nuk kishin njohuri për kompetencat e tyre për zgjidhjen e ankesave në lidhje me zgjedhjet dhe nuk ishin të njoftuar me Kodin e ri zgjedhor.

- Preventivat ligjore për të parandaluar financimin joligjor të fushatës janë joadekuate, për shembull donacione anonime janë të lejuara.

Institucionet e përfaqësuara në MNVZ janë të gatshme të përkrahin autoritetet dhe shoqërinë civile të vendit në përmirësimin e procesit zgjedhor, në pajtueshmëri me synimet dhe përkushtimet e Këshillit të Evropës dhe standardeve tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

---

## TË DHËNAT PRELIMINARE

---

### Prapavija

Më 20 prill, Kryetari i Parlamentit shpalli që zgjedhjet parlamentare në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë do të mbahen më 5 korrik. Zgjedhjet duhej të mbaheshin në tetor 2006, mirëpo partitë politike arritën marrëveshje që zgjedhjet të mbahen në fillim të periudhës 90 ditësh të paraparë për zgjedhje të rregullta. 120 anëtarët e Parlamentit zgjidhen sipas sistemit proporcional rajonal pa kërkesa paraprake. Njëzet deputetë zgjidhen në çdonjërën nga gjashtë njësitë zgjedhore, kufijtë e të cilave janë definuar në Kodin Zgjedhor.

Këto zgjedhje në masë të gjerë konsiderohen si indikator për ambiciet e vendit për integrim mëtutjeshëm në strukturat evropiane dhe euro-atlantike.

Zgjedhjet e fundit parlamentare u mbajtën në vitin 2002. Si rezultat e këtyre zgjedhjeve u formua qeveri nga koalicioni i udhëhequr nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (SDSM) i quajtur “Së bashku për Maqedoninë” dhe nga partia etnike shqiptare e quajtur Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI). Kjo qeveri mbeti në pozitë gjatë tërë mandatit të Parlamentit.

### Korniza Ligjore

Këto zgjedhje u udhëhoqën nga Kodi Zgjedhor gjithëpërfshirës i cili u miratua në fund të marsit të vitit 2006. Edhe pse ky Kod u përfundua vetëm tre muaj para zgjedhjeve, ai siguroi bazë më të qëndrueshme për rrjedhën e zgjedhjeve si dhe themeloi kornizë më të mirë zgjedhor. Për më tepër, më 12 qershor Parlamenti miratoi ndryshimet në Kodin Kriminal që parasheh sanksione më të rrepta për krimet në lidhje me zgjedhjet, duke përfshirë edhe dënime afatgjate me burg.

Komision Shtetëror Zgjedhor (KShZ) rregulloi disa çështje të procedurave zgjedhore në lidhje me, *inter alia*, përbërjen e komisioneve zgjedhore dhe nominimin e anëtarëve të tyre, trajnimin e zyrtarëve zgjedhorë, aktivitetet e policisë, dhe të drejtat dhe obligimet e vëzhguesve. KShZ miratoi një sërë instruksionesh dhe shpjegimesh në disa predispozita të Kodit Zgjedhor.

Implementimi i suksesshëm i kornizës së re ligjore kërkoi që të tre komponentët e procesit zgjedhor, edhe atë votuesit, partitë politike dhe institucionet shtetërore të respektojnë ligjin e shkruar dhe frymën e tij, si dhe të përkrahin sundimin e ligjit. Aspekte të veçanta të Kodit të ri zgjedhor u dëshmuuan të vështira për t’u implementuar, siç është rasti me kërkesën që të gjithë kryetarët e Bordeve Zgjedhore të jenë zyrtarë shtetërorë ose komunalë. Për më tepër, edhe më tej janë të nevojshme shpjegime më të hollësishme të disa dispozitave të Kodit Zgjedhor. Për shembull, ishte i paqartë shpjegimi për atë se çka saktësisht përfaqësojnë “aktivitetet e fushatës”, të ndryshme nga aktivitetet e rregullta partiake, dhe më saktë cilat aktivitete janë të lejuara para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore.

Aktorë të ndryshëm të procesit kanë shprehur brengën e tyre se partitë politike mund të mos i kenë respektuar dispozitat ligjore në lidhje me financimin e fushatës, e posaçërisht limitin e shpenzimeve për fushatë dhe shfrytëzimin e donacioneve të ndaluara. Dispozitat ligjore për të parandaluar financimin joligjor të fushatës zgjedhore mbeten akoma të dobëta; për shembull, donacionet anonime janë të lejuara. Ndërsa, deri sa partitë politike kërkojnë të dorëzojnë raporte financiare në lidhje me financimin e fushatës pas zgjedhjeve, ato nuk kërkojnë të përfshijnë detaje për shpenzimet, por vetëm shumën totale të fondeve të shpenzuara. Rrjedhimisht, institucionet kompetente kanë kufizuar mundësitë për të kryer revizion të detajuar të shpenzimeve të raportuara. Posaçërisht ekziston mangësi në implementimin efektiv dhe në mekanizmat kontrolluese për të siguruar implementim të procesit në pajtueshmëri me rregullativat.

### **Administrata Zgjedhore**

Kodi zgjedhor themelon administratë zgjedhore tre-nivelesh për të gjitha zgjedhjet, duke përfshirë KShZ, 84 Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ-të), dhe 2976 BZ. KShZ ka përbërje të re që u emërua më 14 prill nga Parlamenti. Në pajtueshmëri me Kodin Zgjedhore, partitë opozitare, në këtë rast Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar të maqedonasve (VMRO-DPMNE) propozoi Kryetarin e KShZ-së, përderisa partitë qeveritare, në këtë rast BDI, propozoi Nënkryetarin. Pesë anëtarët e tjerë të KShZ-së u nominuan nga partitë tjera më të mëdha politike.

Për herë të parë, anëtarët dhe zëvendësit e anëtarëve të KKZ-ve dhe të BZ-ve u zgjodhën nga radhët e nëpunësve shtetërorë duke përdorur kryesisht bazën e kompjuterizuar të të dhënave, dhe jo të nominuar nga partitë politike. Në bazë të dispozitave kalimtare të Kodit për këto zgjedhje, dy anëtarë të BZ-ve u nominuan nga partitë, një nga partitë kryesore qeveritare dhe një nga partitë kryesore opozitare. Kryetarët dhe zëvendësit e tyre u zgjodhën nga radhët e zyrtarëve të administratës shtetërore dhe komunale, ndërsa anëtarët tjerë dhe zëvendësit e tyre u zgjodhën nga radhët e zyrtarëve të administratës publike. Gjatë përcaktimit të anëtarëve të komisioneve dhe bordeve duhej të përkujdesen kritere specifike në lidhje me balancimin gjinor dhe etnik. Meqë gjatë zgjedhjes së zyrtarëve nga radhët e banorëve lokalë nuk mundën të përmbushen të gjitha kriteret, përafërsisht 3000 zyrtarë zgjedhorë u detyruan të shërbejnë në KKZ-të dhe BZ-të larg vendbanimeve të tyre. Së bashku me KKZ-të dhe institucionet shtetërore e komunale, KShZ nënvizoi nevojën që zyrtarët të qëndrojnë në vendbanimet e tyre një kohë të caktuar gjatë ditës së zgjedhjeve më qëllim që të kenë mundësinë të votojnë.

Gjatë pjesës më të madhe të kohës, KShZ punoi në mënyrë efektive dhe kolegjiale. Formularët, udhëzimet dhe rregullativat e nevojshme për kryerjen e votimit u miratuan brenda afateve ligjore dhe u shpallën në internet faqen e KShZ. KShZ ndërmori një përpjekje të kufizuar për edukimin e votuesve që përfshiu prodhimin e disa materialeve të shtypura dhe tre klipe televizive. Për herë të parë, KShZ u ndihmua nga një sekretariat i përhershëm që dha kontribut në efikasitetin e punës së tij.

Sidoqoftë, ekzemplarët e fletëvotimeve, që duhej të përgatiten veçmas për secilën nga gjashtë njësitë zgjedhore, dhe në kombinime të ndryshme të gjuhëve zyrtare varësisht prej komunës, u aprovuan me një vonesë të vogël. E gjithë kjo rezultoi me një proces të çrregulluar nga një sërë mosmarrëveshjesh brenda KShZ-së në lidhje me çështjen, të përcjella me indikator të presionit të hapur politik mbi KShZ dhe Kryetarin e tij. Mosmarrëveshjet i referoheshin dizajnit të emrit të koalicionit të VMRO-DPMNE në fletëvotimin, gjatë të cilës Kryetari i KShZ, i cili është i nominuar nga VMRO-DPMNE, publikisht u kërcënua që do të jep dorëheqje. Pas konsultimeve me liderët e partive kryesore

opozitare dhe qeveritare u arrit kompromis mes Kryetarit të KShZ dhe anëtarëve tjerë të KShZ. Në fund, fletëvotimet u botuan dhe u shpërndanë me kohë nëpër Bordet Zgjedhore.

Përveç takimeve të rregullta, të cilat ishin të hapura për publikun dhe vëzhguesit, KShZ gjithashtu mbajti disa takime joformale të mbyllura. Disa herë kjo rezultoi me hamendje mes vet anëtarëve të KShZ për atë se çka ka qenë zyrtarisht e vendosur apo e rregulluar gjatë këtyre “para-takimeve”. Në kërkesë të MVZ të OSBE/ODIHR, KShZ hapi këto para-takime për vëzhguesit e misionit. Edhe pse KShZ themeloi grupin punuese që kishte për detyrë të skicojnë rregullat për procedurat e tij, ato u miratuan një ditë para ditës së zgjedhjeve, që është shumë vonë të përmirësohet organizimi i brendshëm dhe transparenca e punës së KShZ. KShZ më 4 korrik filloi së miratuari procesverbalet e takimeve të mëparshme.

KShZ organizoi trajnim detyrimor për KKZ-të dhe BZ-të. Trajnimi për anëtarët e BZ u bë me një vonesë të konsiderueshme në krahasim me orarin fillestar. Shpjegimet e procedurave gjatë sesioneve të trajnimit nuk ishin gjithnjë të duhurat. Efekti negativ i këtij shpjegimi jo të duhur u përkeqësua me faktin që manuali oficial i procedurave të KShZ nuk arriti me kohë deri te anëtarët e BZ.

### **Lista e Votuesve**

Prej 5 deri më 19 maj Ministria e drejtësisë lëshoi në kontrollim publik disa pjesë të Listës së Votuesve nëpër zyrat e saj rajonale. Si rezultat i përvojës së mëparshme, Ministria e drejtësisë gjithashtu u mundësoi qytetarëve që nëpërmjet të internetit të kontrollojnë nëse janë të përfshirë në listën e votuesve, si dhe udhëhoqën disa projekte tjera së bashku me organizatën vendase për vëzhgim MOST për t'i inkurajuar qytetarët të kontrollojnë emrat e tyre në listë. Janë bërë më tepër se 20000 kontrole. Paraprakisht Ministria e drejtësisë kishte përmirësuar LV dhe ka mënjanuar emrat e 6000 personave të vdekur.

Si në zgjedhjet e mëparshme edhe këtë herë disa parti shprehën dyshimet e tyre në lidhje me validitetin e LV, por vetëm disa kërkesa konkrete u iniciuan brenda afateve ligjore për ankesa. Shumica e brengave u referoheshin votuesve që jetojnë jashtë vendit dhe mundësisë që në emër të tyre të votojnë të tjerë. Në bazë të ligjit, personat e tillë mbeten në listën e votuesve për aq kohë sa kanë të regjistruar vendbanim në vend. Në tentim të minimizohet potenciali i parregullsive, Ministria e drejtësisë ka vënë një yll si shenjë parën emrave të 58500 personave në LV për të cilët autoritetet kanë të dhëna se ndodhen jashtë shtetit për më tepër se një vit.

Më 12 qershor KShZ nënshkroi të 2976 kopjet e listave zgjedhore për vendet votuese, si dhe 51 pjesët e posaçme të listës së votuesve që janë përdorur për votim të hershëm më 4 korrik nëpër njësitë ushtarake, burgje, dhe nga njerëzit e zhvendosur brenda shtetit. Gjithsej 3514 votues (0.2 përqind nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar) mund të votonin nën procedurat e votimit të hershëm. Derisa Kodi zgjedhor u mundëson votim të hershëm personave ushtarak dhe të burgosur, ai nuk i përfshin personat e zhvendosur, prandaj instruksionet e KShZ tejkaluan parashikimet e Kodit Zgjedhor.

### **Regjistrimi i Kandidatëve**

Më 2 qershor KShZ finalizoi regjistrimin e listës së kandidatëve. Gjithsej 31 parti politike dhe koalicione, si dhe dy grupe të votuesve dorëzuan listat e kandidatëve për një apo më tepër Njësi Zgjedhore., nga të cilat të gjitha u miratuan nga KShZ me anë të një procesi gjithëpërfshirës. Në përgjithësi u regjistruan 135 lista. Njëmbëdhjetë parti dhe koalicione garuan në të gjitha gjashtë njësi, dhe shtatë parti dhe koalicione dorëzuan listat në pesë nga gjithsej gjashtë njësi zgjedhore.

Katër parti dhe dy grupe votuesish dorëzuan listat për vetëm një Njësi Zgjedhore. Numri i kandidatëve për një njësi zgjedhore ndryshon prej 19 deri në 29.

Disa brenga u shprehën në lidhje me vendimin e PDSH-së për të vendosur një person ndaj të cilit po zhvillohen dy procese gjyqësore dhe një tjetër për të cilin po zhvillohen hetime për krime lufte.

### Atmosfera e Fushatës

Politika parimisht ndahet në linjë etnike, dhe garat kyçe u zhvilluan në mes partive të një etniteti që garuan për votat brenda komuniteteve të tyre. Ndarja politike ka ardhur në shprehje prej vitit 2002, posaçërisht në anën etnike maqedonase, me një numër të partive të reja që sfidojnë dy rivalët kryesorë brenda komunitetit etnik maqedonas, “Për Maqedoninë së bashku” dhe VMRO-DPMNE-në. Partitë e reja përfshijnë edhe VMRO-Partia Popullore (VMRO-NP), e cila u nda nga VMRO-DPMNE në fund të vitit 2004, Partia e Re Social Demokratike (NSDP) e cila u formua në tetor 2005 nga zyrtar i lartë i SDSM, Tito Petkovski, dhe Rindërtimi Demokratik I Maqedonisë (DOM) e formuar në janar 2006 nga Liljana Popovska, zyrtar i mëparshëm I partnerit në koalicion me SDSM, Partia Liberal Demokratike (LDP). Partitë kryesore shqiptare pjesëmarrëse të Parlamentit të deritanishëm, Bashkimi Demokratik për Integrim dhe Partia Demokratike Shqiptare janë gjithashtu garuesit kryesor në këto zgjedhje. BDI garoi në këto zgjedhje në koalicion me dy parti tjera më të vogla, nga të cilat njëra përfaqëson pakicën boshnjake.

Përskaj faktit që Kodi Zgjedhor parasheh fillimin e fushatës më 15 qershor, disa parti politike kryen aktivitete partiake, që gjerësisht konsiderohen si fushatë, para kësaj date, duke përfshirë konventa, vendosjen e billbordeve, dhe turne të liderëve partiakë. U bënë akuza të ndërsjella se kjo ka thyer Kodin Zgjedhor, sidoqoftë, Komisioni Shtetëror Zgjedhor deklaroi që nuk është në kompetenca të tij të komentojë këtë çështje.

Edhe pse shumica e liderëve të partive pjesëmarrëse në garën zgjedhore morën pjesë në nënshkrimin e Kodit të Mirësjelljes për zgjedhje të rregullta më 13 qershor, në pjesën e parë të fushatës u shënuan një sërë incidentesh të dhunshme, akuza dhe kundër-akuza. Shumica e këtyre incidenteve ndodhën në pjesën veri-perëndimore të vendit, në të cilat ishin të përfshira PDSH dhe BDI. Këto involvuan një sërë sulmesh mbi aktivistët partiakë dhe shtabe zgjedhore, gjegjësisht në Saraj dhe Tearcë. Sulme u shënuan në komunat e Likovës, Studeniçanit, Tetovës, dhe Strugës. Në një incident të armatosur në Saraj që ndodhi në natën mes 18-19 qershorit ishin të përfshirë aktivistë të PDSH dhe BDI; nuk kishte të lënduar nga ky incident. Në një incident tjetër më 24 qershor mes aktivistëve të PDSH dhe BDI në fshatin Rashçe (komuna Saraj), disa protagonistë u rrahën dhe njëri u plagos me armë zjarri.

Në natën mes 21-22 qershorit në qendër të Shkupit ndodhi një përleshje mes aktivistëve të SDSM dhe VMRO-DPMNE. Kjo përleshje ishte rezultat I mosmarrëveshjes në lidhje me vendosjen e posterëve. Incidenti, për të cilin partitë akuzuan njëra-tjetrën, sipas disa burimeve **involvoi** edhe gjuajtje me armë.

Partitë politike raportuan akuza të përgjithshme në MVZ të OSBE/ODIHR për presion mbi votuesit, duke përfshirë edhe kërcënime dhe blerje, posaçërisht ndaj komuniteteve më të ndjeshme pakicë dhe ndaj të punësuarve në sektorin publik. Këtu përfshihen kërcënime për humbje të vendeve të punës ose të beneficioneve sociale. Në një rast, një nga liderët e komunitetit të shoqërisë civile raportoi që i është ofruar një shumë e madhe të hollash nga një parti politike për të mos marrë pjesë në fushatën zgjedhore të ndonjë partie tjetër.

Disa parti u ankuan në MVZ që aktivistët e tyre partiak në disa rajone janë tërhequr për shkak të sulmeve të dhunshme apo akuzave. MVZ ka vënë re se fushata e BDI në komunat Saraj dhe Tearcë u hodh në hije për shkak të një sërë sulmesh mbi shtabet e tij. PDSH akuzoi se aktivitetet e tyre të fushatës janë dëmtuar në rajonet rreth Kërçovës. NSDP deklaroi se ka pasur vështirësi për të hapur shtabe në komunat e Kërçovës, Kumanovës dhe Gjevgjeliës, për çka fajësoi oponentët politik për presion.

Partitë opozitare në veçanti kanë bërë akuza për keqpërdorim të burimeve administrative, e posaçërisht nga zyrat e kryetarëve të komunave. MVZ ka vënë re se hapësira e ndërtesës së komunës Karposh në Shkup është përdorur si shtab kryesor për fushatën e prefektit, I cili gjithashtu ishte kandidat i koalicionit “Për Maqedoninë së bashku”. Ngjashëm me këtë, në Shuto Orizarë të punësuar në administratë pranuan që kanë shfrytëzuar resurset komunale siç janë automjetet, resurset njerëzore dhe telefonat për qëllime të fushatës.

Komisioni Shtetëror për Antikorrupcion identifikoi dy (tre?) raste të shitjes joligjore të pronës shtetërore gjatë fushatës zgjedhore, gjegjësisht shitjen e aksioneve të termo elektranës “Negotino” dhe tokë ndërtimi në Shkup. Komisioni u tregua I ashpër në dënimin publik të thyerjeve të tilla të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit, dhe ftoi të gjitha institucionet që me efikasitet të mbrojnë interesin publik si dhe të ndërmarrin të gjitha masat ligjore që u qëndrojnë në disponim për të hetuar thyerjen e ligjit.

Partitë politike, sidomos ato të opozitës, shpesh kanë shprehur mosbesimin e tyre në procesin zgjedhor, si dhe një mosbesim të konsiderueshëm ndaj partive tjera. Në deklaratat që me mëdyshje dëmtuan besimin në agjensionet për sundimin e ligjit, liderët e PDSH tërë kohën akuzuan policinë për përkatësi politike në favor të BDI, posaçërisht gjatë përlëshjeve në Saraj. Ministri I punëve të brendshme publikisht hodhi poshtë akuzat e tilla.

Mes partive më të mëdha etnike maqedonase, fushata u fokusua në çështjet ekonomike dhe sociale dhe në prospektet për integritet Evropian. Partitë fuqimisht kritikuan programet e njëra-tjetrës. Për dallim prej këtyre, fushatat e PDSH dhe BDI u përqendruan në suksesin apo dështimin e qeverisë në avancimin e interesave të komunitetit shqiptar. Karakteristikë negative e fushatës ishte që përfshinte ofendime të adresuara liderëve të partive rivale. PDSH drejtoi retorikë shumë të pakëndshme drejt liderit të BDI. Në fazat e fundit të fushatës u shënuar rritje e burimeve negative të fushatës, posaçërisht u përfshinë akuza të ndërsjella për korrupsion drejtuar liderëve të SDSM-së dhe VMRO-DPMNE-së, duke përfshirë edhe fushatë posterësh dhe reklama nëpër shtyp që shfaqin liderin e VMRO-DPMNE në dritë negative.

### **Pjesëmarrja e Pakicave Kombëtare dhe Femrave**

Përveç shqiptarëve, edhe pakicat tjera (romët, turqit, vllahët, serbët dhe boshnjakët) kanë partitë e tyre që deklarojnë se përfaqësojnë interesat e tyre, dhe shumica e komuniteteve përfaqësohen nga më tepër se një parti. Shumica e partive që përfaqësojnë pakicat më të vogla në këto zgjedhje morën pjesë si pjesë e dy koalicioneve më të mëdha.

Kodi Zgjedhor parasheh që në komunat ku të paktën 20 përqind e popullatës janë “anëtarë të komuniteteve tjera etnike”, përbërja e KKZ dhe BZ duhet patjetër të bazohet në principin e “përfaqësimit adekuat dhe të duhur”, dhe përdorimi i gjuhës së minoritetit në organet administrative zgjedhore është obligative. Këto kritere vlejné edhe për fletëvotimet dhe për të gjithë formularët dhe dokumentet zyrtare.

Misioni i OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve pranoi disa raporte për manipulime zgjedhore që ndikojnë komunitetet pakicë, përfshirë këtu edhe tentimet për blerje votash në kompensim të një shume të vogël të hollash, ushqim apo falje të borxheve të vogla; kërcënime për humbje të beneficioneve sociale apo të shërbimeve tjera publike; si dhe presione dhe kërcënime më të rënda në disa lokacione. OSBE/ODIHR ka vënë re se në Shtip, disa dokumentet identifikimi të pjesëtarëve të komunitetit rom janë lënë si garancion për kredi në disa shitore lokale. Partitë politike keqpërdorin këtë rrethanë gjatë zgjedhjeve duke paguar këto borxhe në shkëmbim të votave. Një lider partie në Shtip ka informuar MVZ që kjo është një praktikë e zakonshme dhe shpjegoi se partia e tyre do t'i jepte 500 Euro pronarit të shitores për të mbuluar borxhet e anëtarëve të tyre. Pasi dokumentet për identifikim janë të nevojshme për të votuar, ekziston mundësia që këta qytetarë të jenë të provuar prej mundësisë për të votuar.

Këto praktika, që më tepër janë çështje të varfërisë sesa të çështjes etnike në veçanti ndikojnë mbi grupet e ndjeshme sociale dhe ekonomike, e posaçërisht romët. Disa persona të përfshirë nuk ishin të vetëdijshëm që blerja e votave është akt kriminal i dënuar me ligj, edhe atë me të paktën pesë vite burg. MVZ gjithashtu ka marrë indikacione që disa pjesëtarë të komunitetit rom mund të jenë të aprovuar nga mundësia për të votuar për shkak të mungesës së regjistrimit civil dhe dokumenteve të duhura të identifikimit.

Dispozitat e Kodit Zgjedhor kanë për qëllim avancimin e pjesëmarrjes së femrave në politikë. Sipas Kodit, të paktën një nga tre vende në listën e kandidatëve duhet të plotësohet nga një kandidat të gjinisë më pak të përfaqësuar. Kjo dispozitë u respektua nga të gjithë dorëzuesit e listave të kandidatëve. Kodi Zgjedhor gjithashtu parasheh që çdo gjini duhet të mbajë të paktën 30 përqind të pozitave në organet e administratës zgjedhore. Vëzhguesit afatgjatë raportuan se ky kriter nuk është përmbushur në gjashtë nga 84 KKZ.

## **Mediat**

Gjatë periudhës 20 ditësh të fushatës, mediat elektronike dhe të shtypura në nivel kombëtar u siguruan votuesve informata ditore në lidhje me aktivitetet zgjedhore dhe qëndrimet e kandidatëve. Informatat për fushatën gjithashtu përfshinë edicione të posaçme në lidhje me zgjedhjet që mbuluan aktivitetet e garuesve dhe u emituan rregullisht në televizionet kryesore publike dhe private.

Korniza ligjore që rregullon punën e mediave gjatë fushatës përfshin Kodin Zgjedhor, Rregullat për Përfaqësim të Barabartë Medial, dhe dispozita relevante të Ligjit për Aktivitete Radiodifuzive.

Transmetuesi publik, Televizioni Maqedonas (MTV) punoi në pajtueshmëri me dispozitat ligjore për ndarjen e terminit të lirë për emitim për dorëzuesit e listave të kandidatëve; koha e emitimit u përcaktua në bazë të numrit të listave të dorëzuara të kandidatëve. Si shtesë, MTV ishte nikoqir i një numri debatesh në kanalën e tretë MTV+, secila e fokusuar në temë të ndryshme, edhe pse nuk u mbajt asnjë debat mes liderëve të dy partive më të mëdha maqedonase. Një sërë forumesh që përfshinë kandidatët shqiptar u emituan në MTV2, i cili emiton program kryesisht në shqip.

Misioni i OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve bëri analizë të medimeve kryesore elektronike dhe të shtypura qysh para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore (2-14 qershor) dhe nga 15 qershori e deri në ditën e zgjedhjeve. Rezultatet e monitorimit tregojnë se në periudhën para fillimit zyrtar të fushatës, transmetuesi publik dhe gazetat mbuluan aktivitetet e Qeverisë gjatë tërë kohës.

Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, në programin e natës të MTV1 koalicioni qeveritar "Për Maqedoninë së bashku" kishte 23 përqind të kohës së rezervuar për subjektet politike, ndërsa



koalicioni VMRO-DPMNE kishte 17 përqind të kohës për politikë. Prezenca e përfaqësuesve qeveritarë duke ushtruar detyrën zyrtare, në të dy stacionet televizive të monitoruara ishin të përfaqësuar në lajme dukshëm më shumë sesa në kanalet private (12 përqind dhe 11 përqind në MTV1 dhe MTV2 në krahasim me mesataren prej 3.6 përqind në tre televizionet private të monitoruara).

MTV2 në lajmet e veta në gjuhën shqipe u siguroi përfaqësuesve të BDI dy herë më tepër hapësirë sesa atyre të PDSH (39 përqind për BDI, 15 përqind për PDSH). Për më tepër, ky kanal televiziv në kohën më të shikuar më 2 korrik emitoi dokumentar dedikuar Ali Ahmetit që lavdëronte personalitetin e tij. Në anën tjetër, një mbulim më të balancuar të dy partive kryesore shqiptare u siguroi nga MTV2 në edicionin e posaçëm për zgjedhje të quajtura Kronika Zgjedhore.

Televizionet private TV A1 dhe Kanali 5 u treguan të balancuar në edicionet e lajmeve dhe në mbulimin e të dy koalicioneve më kryesore, ndërsa TV Sitel favorizoi opozitën në aspektin kuantitativ të emitimit (42 përqind për koalicionin VMRO-DPMNE, në krahasim me 19 përqind për koalicionin qeveritar Së bashku për Maqedoninë). TV A1 fokusoi edicionet e lajmeve në Partinë për Rindërtim Ekonomik (PEO) më shumë sesa në garuesit kryesorë (19 përqind për PEO, 13 përqind për koalicionin qeveritar dhe 13 përqind për koalicionin VMRO-DPMNE).

Kanalet private dhe publike dështuan që emitimin e programeve të tyre ta kryejnë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore që transmetuesit publik të mbulojnë të gjithë garuesit në mënyrë proporcionale me numrin e njësive ku ata garojnë. Kjo dispozitë u dëshmuar si problematike për transmetuesit për t'u implementuar, kryesisht për shkak të intensitetit të ndryshëm të aktiviteteve zgjedhore të organizuara nga dorëzuesit e ndryshëm të listave.

Një sasi e konsiderueshme e reklamimit të paguar u shpall në mediumet kombëtare të shtypura dhe elektronike, kryesisht të partive dhe koalicioneve kryesore. PEO, lideri i të cilës është gjithashtu pronar i TV A1, kishte një program të paguar që intenzivisht u emitua në këtë kanal televiziv.

Kolumnat dhe komentet që përmbajnë një rang të këndvështrimeve të ndryshme politike u publikuan nëpër gazetat ditore. Gazetat pajisën votuesit me informata për aktivitetet zgjedhore dhe për aspektet teknike dhe procedurale të procesit zgjedhor.

Në përgjithësi, niveli i mbulimit nga mediumet e shtypura dhe elektronike ishte mesatar, me disa komente partiake në një numër të mediave private.

## **Ankesat dhe Apelet**

Mbrojtja e të drejtave të kandidatëve garantohet nga dy procedura të ndryshme. Kandidatët mund të iniciojnë procedurë në lidhje me thyerjen e të drejtave të tyre gjatë fushatës zgjedhore në gjyqet e kategorisë së parë, për vendimet e të cilëve mund të dërgohet ankesë në Gjykatën e Apelit. Kandidatët gjithashtu mund të kërkojnë mbrojtje të drejtave të tyre nga KShZ, dhe të ankohen për vendimet e KShZ në Gjykatën Supreme. Përveç kësaj, çdo votues ka të drejtë të dërgojë ankesë deri te KShZ në lidhje me të drejtat e tij apo të saj për të votuar, dhe ankesë të mëtejshme në Gjykatën Supreme. Për të gjitha procedurat ekziston afat i shkurtë për dorëzimin e vendimeve.

Pothuajse gjysma e gjykatave të kategorisë së parë të cilat u kontaktuan nga MVZ nuk kishin njohuri për kompetencat dhe obligimet e veta në zgjedhjen e ankesave të lidhura me zgjedhjet, dhe nuk ishin të informuar për Kodin e ri zgjedhor.

## Vëzhguesit Vendas

Kodi Zgjedhor parasheh vëzhgim vendor dhe ndërkombëtar. Tentimi më i madh për vëzhgim vendor u organizua nga Asociacioni Qytetar MOST, i cili ka vëzhguar zgjedhje qysh prej vitit 2002 dhe ka shpërndarë 3500 vëzhgues për këto zgjedhje. Përveç vëzhgimit të fushatës dhe ditës së zgjedhjeve, MOST ka bërë përpunimin statistikor të rezultateve të bazuara në protokollin zyrtar në gjashtë njësi. Ky përpunim i votave quhet “ tabelizim paralel i votave”.

## Dita e Zgjedhjeve dhe Numërimi i Votave

Dita e zgjedhjeve rrodhi në një atmosferë përgjithësisht të qetë, dhe procesi rrodhi me rregull në pjesën më të madhe të vendit. Megjithatë, parregullsi serioze, që dëmtuan univerzalitetin dhe barabarësinë e votës u raportuan nga një sërë komunash, në veçanti nga Bogovinja, Brvenica, Gostivari, Struga, Studeniçani, Tearce, Zajazi, dhe Zhelina. Vëzhguesit e MNVZ raportuan raste të mbushjes së kutive, blerjes së votave, vjedhje të fletëvotimeve dhe materialeve tjera zgjedhore, votim për dikë tjetër dhe votim grupor, si dhe tension dhe kërcënime, edhe nga grupe të armatosura. Votimi në disa vendvotime u desh të anulohet për shkak të incidenteve të tilla.

Vëzhguesit e MNVZ vizituan 1700 vendvotime në tërë vendin. Procedurat e hapjes së vendvotimeve u vlerësuan pozitivisht në 95 përqind të vendeve të vizituara. Problemet që janë vënë re përfshijnë procesverbale jo të plotësuara në mënyrë të duhur para hapjes së vendvotimit (15 përqind), mosregjistrim të numrave serik të kutive votuese (8 përqind), dhe përfaqësuesve të partive dhe vëzhguesve nuk u janë treguar kutitë e zbrazëta (15 përqind). Në disa raste ka munguar material i rëndësishëm zgjedhor.

Procesi i votimit u vlerësua si “i keq” apo “shumë i keq” në 5 përqind të vendvotimeve të vizituara. Votimi për dikë tjetër është vënë re në 4 përqind të vendvotimeve të vizituara, dhe votimi familjar në 20 përqind. Indikator të qartë të mbushjes së kutive janë vërejtur në dhjetë raste. Në 7 përqind të vendvotimeve vëzhguesit kanë vënë re shume nënshkrime identike në listën e votuesve, dhe në 2 përqind votuesit nuk kanë nënshkruar listën. Në 3 përqind të vendvotimeve kutitë e votave nuk kanë qenë mirë të plumbuara. Votuesve nuk u kontrollohej fare, apo kontrollohej rrallë, ngjyra e padukshme, ose po ajo fare nuk përdorej, edhe atë në 7 dhe 4 përqind. Në 5 përqind të vendvotimeve, një apo të dy vultat nuk janë vënë re në disa raste me çka praktikisht këto vota janë bërë jovalide. Në 13 përqind të vendvotimeve, votuesit jo gjithnjë kanë shënuar votën e tyre në fshehtësi, dhe tentime për të ndikuar mbi votuesit dhe raste ku një person “ka ndihmuar” një numër votuesish janë raportuar në 4 përqind. Puna e BZ u vlerësua si “e mirë” apo “shumë e mirë” në 97 përqind të vendvotimeve, dhe shumë mangësi procedurale ishin rezultat të mungesës së përvojës dhe trajnimit adekuat.

Blerje votash u raportuan në Radovish dhe Koçani (që përfshinë romët), dhe u raportuan përpjekje për blerje votash në Strumicë dhe Sveti Nikolë. Presion i panevojshëm mbi votuesit nga të punësuarit u raportua në Çeshinovo – Obleshevë. Kërcënim dhe frikësim të votuesve romë u raportua në Shtip. Fletëvotimet dhe materialet tjera zgjedhore ishin vjedhur në Bogovinë, Brvenicë, Tearcë, dhe Zhelinë. Vëzhguesit e MNVZ u penguan të kryejnë detyrat në katër raste duke u kërcënuar apo frikësuar.

Për tension dhe mungesë të qetësisë brenda vendvotimeve janë raportuar në 1 përqind të vendvotimeve të vizituara, që është përqindje e njëjtë më rastet e kërcënimeve. Prezenca e personave të paautorizuar është vërejtur në 2 përqind të vendvotimeve, dhe në 2 përqind ata kanë ndërhyrë apo

drejtuar punën e BZ-ve. Prezenca e shumë njerëzve apo organizim i dobët kanë penguar procesin në 6 përqind të vendvotimeve, dhe vetëm një vendvotim nga dy është vlerësuar si i volitshëm për personat me hendikep.

MNVZ gjithashtu ka bërë vëzhgim të pjesërishtëm të votimit të hershëm të ushtarëve, të burgosurve, personave të zhvendosur, dhe personave që votojnë nga shtëpitë e tyre. Vetëm disa gabime procedurale janë vënë re që u paraqitën si rezultat i mungesës së trajnimit të BZ-ve. Në kampin e Kumanovës të personave të zhvendosur një numër i konsiderueshëm i personave nuk ishin në Listën e Votuesve ngase, sipas raporteve, kishin humbur statusin e tyre si persona të zhvendosur brenda shtetit.

Megjithatë, situata humbi orientimin gjatë numërimit të votave, me 15 përqind të numërimeve të vlerësuara keq ose shumë keq. Problemet më të mëdha procedurale janë vëzhguar në 12 përqind të rasteve, të kuptuarit e procedurave nga BZ është vlerësuar i dobët apo shumë i dobët në 10 përqind të rasteve, ndërsa organizimi u vlerësua i dobët apo shumë i dobët në 12 përqind. Edhe pse nuk janë vënë re raste të qëllimshme për falsifikim, parregullsi serioze gjatë numërimit u raportuan në 7 përqind të vendeve të vizituara.

Procedurat kyçe nuk janë ndjekur dhe masat për parandalimin e parregullsive nuk janë implementuar. Kjo përfshin mosnumërimin e nënshkrimeve në listën e votuesve (16 përqind) dhe moskrahësimi i listës zgjedhore me fletëvotimet e pashfrytëzuara (19 përqind). Në 29 përqind të rasteve të vëzhguara këto procedura nuk janë kompletuar para hapjes së kutive, dhe në 9 përqind të rasteve nuk është bërë regjistrimi i këtyre numrave dallues në protokollin e rezultateve. Numrat serik të pllombave të kutive nuk është kontrolluar në 19 përqind të rasteve të vëzhguara. Vlerësimi i votave të vlefshme dhe jo të vlefshme u vlerësua si jo i duhur në 8 përqind të numërimeve të monitoruara, dhe në 24 përqind të rasteve ka pasur mosmarrëveshje për vlefshmërinë e fletëvotimeve mes anëtarëve të BZ. Kur vlefshmëria u aprovua nëpërmjet votimit të anëtarëve të BZ, bordi dështoi të shënojë këtë në pjesën e prapme të fletëvotimit, edhe atë në 74 përqind të rasteve. Në 4 përqind të rasteve fletëvotimet nuk u ndanë në pjesë sipas garuesve, dhe në 4 përqind të rasteve rezultatet nuk u numëruan në mënyrë të duhur. Tension dhe mungesë e qetësisë u raportua në 5 përqind të rasteve të numërimit, ndërsa prezenca e personave të paautorizuar u raportua në 4 përqind.

Përfaqësuesit e autorizuar të partive politike ishin prezent në 94 përqind të vendvotimeve gjatë procesit të votimit dhe në 94 përqind të vendvotimeve gjatë numërimit të votave. Vëzhguesit vendor jo-partiakë ishin prezent në 67 dhe 68 përqind të rasteve. Vëzhguesit e MNVZ raportuan që policia ka luajtur rol pozitiv në mirëmbajtjen e rendit, kur intervenim i tillë ka qenë i nevojshëm.

Vëzhguesit e MNVZ gjithashtu KKZ-të gjatë fazave fillestare të tabelizimit, proces i cili në përgjithësi rrodhi në pajtueshmëri me procedurat, edhe pse në disa raste janë vënë re parregullsi në dërgimin e rezultateve protokollare deri te KKZ-të.

*Këtë deklaratë gjithashtu mund t'a keni në gjuhën maqedonase dhe shqipe.  
Megjithatë, si dokument zyrtar mbetet versioni në gjuhën angleze.*

---

#### INFORMATA PËR MISIONIN DHE MIRËNJOHJE

---

Ambasadorja Odri Glovër (Britani e Madhe) është Shef i Misionit të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve. Z. Mevlüt Çavuşoğlu (Turqi) udhëhoqi Asambleenë Parlamentare të delegacionit të Këshillit të Evropës (PACE).

Misioni i OSBE/ODIHR për Vëzhgimin e Zgjedhjeve u hap më 30 maj në Shkup dhe filloi me 30 ekspertë dhe vëzhgues afatgjatë të vendosur në Shkup dhe në qendrat rajonale. Në ditën e zgjedhjeve, MNVZ shpërndau rreth 382 vëzhgues afatshkurtër nga 45 shtete anëtare të OSBE-së, duke përfshirë këtu edhe delegacionin 18 anëtarësh nga PACE. MNVZ vëzhgoi zgjedhjet në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë në 1700 vendvotime, nga gjithsej 2976 dhe numërimi i votave u vëzhgua në 147 vendvotime. MNVZ gjithashtu ishte prezent në të gjitha 84 Komisionet Komunale Zgjedhore për të vëzhguar tabelizimin e rezultateve.

MNVZ dëshiron të falenderojë Ministrinë e Punëve të Jashtme, Komisionin Shtetëror Zgjedhor, dhe autoritetet tjera kombëtare dhe lokale për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre gjatë procesit të vëzhgimit. MNVZ gjithashtu dëshiron t'i shpreh mirënjohje Misionit Monitorues të OSBE në Shkup dhe organizatave tjera ndërkombëtare, ambasadave për përkrahjen e tyre gjatë misionit.

Për informata më të hollësishme, ju lutemi kontaktoni:

- Urdur Gunnarsdottir, OSBE/ODIHR Zëdhënëse (+48-603-683 122); ose Holly Ruthrauff, OSBE/ODIHR Këshilltar për Zgjedhje, në Varshavë (+48-603-793 783);
- Bas Klein, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, në Strasburg (+33-662265489);